

E.K.

Vendimi i KLP nr.269, datë 17.11.2020 për rrëzimin e kërkesës së ILD për procedim disiplinor me masën “*Vërejtje publike*” ndaj magjistrates E.K. është ankimuar nga ILD në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka vendosur “Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë dhe shfuqizimin e aktit administrative, vendimi nr.269, datë 17.11.2020 i KLP”. Pas rekursit të KLP, me vendimin nr.185, datë 25.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është vendosur ‘Lënia në fuqi e vendimit nr.86 datë 13.12.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, duke konfirmuar përfundimisht vendimin e gjykatës për shfuqizimin e vendimit të KLP-së për rrëzimin e kërkesës së ILD-së për marrje masë disiplinore.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen e dt.13.11.2024 me vendimin nr.224, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratit E.K., pa një vendim përfundimtar. (E.K. kishte humbur statusin për shkak të largimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, më 12.09.2024)